

U-POLIS
Nr. 115/25 Prot.
Datë: 10.02.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME BORDIN E AKREDITIMIT DHE
NDËRKOMBËTARIZIMIN

Nr. 80/13 Prot.

Tiranë, më 07.02.2025

LËNDA: Përcillet vendimi i Bordit të Akreditimit

UNIVERSITETI POLIS

*Rruga Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar Kodi Postar 1051, Kutia
Postare 2995*

TIRANË

Bordi i Akreditimit, në mbledhjen e tij të radhës, të mbajtur më datë 14 Dhjetor 2024, mori vendime që lidhen me vlerësimin e jashtëm në kuadër të disa programeve të studimit. Lutemi, gjeni bashkëngjitur, vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 221, datë 14.12.2024. Gjithashtu ju bëjmë me dije se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ASCAL.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM


Xhiliola Bixheku



Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 221, datë 14.12.2024

PËR

**AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT TË
CIKLIT TË TRETË MASTER EKZEKUTIV NË “RESTAURIM, KONSERVIM DHE
VALORIZIM TË TRASHËGIMISË KULTURORE”, TË UNIVERSITETIT “POLIS”**

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 224, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2024, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të përbashkët të studimit të ciklit të tretë, Master Ekzekutiv në **“Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore”**, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master Ekzekutiv në **“Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore”**
- b) Cikli i studimit: Cikli i tretë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 351, datë 17.09.2021, ndryshuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 82, datë 20.02.2024
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti “Polis”, në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës, Itali
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Kërkimit Shkencor
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 1 vit / 2 semestra
- g) Kredite (ECTS): 60 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: diplomë e përbashkët që ofrohet nga Universiteti “Polis” dhe Universiteti i Ferrarës, Itali
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 8

pasi **mori në shqyrtim:**

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimi të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”*” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësi si më poshtë:
 1. Në dokumentet e studentëve të këtij programi studimi, që mbahen në sekretarinë e Universitetit “Polis”, përfshihen vetëm aktivitetet e organizuara në Shqipëri dhe mungojnë të dhënat e aktiviteteve që studentët kryejnë në institucionin partner, në Itali.
 2. Mungesa e një qasjeje proaktive në aktivitetet e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë së këtij programi studimi.
 3. Infrastruktura laboratorike, në funksion të këtij programi studimi, është e limituar.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,


VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e përbashkët të studimit Master Ekzekutiv në **“Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore”**, të Universitetit **“Polis”**.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **5 (pesë)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **13.12.2029**.

4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar
DARINKA PIQANI		Anëtar
DRITAN NAÇE		Anëtar

INDRIT HOXHA

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Hoxha', with a horizontal line underneath.

Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 221, datë 14.12.2024, "Për akreditimin e parë të programit të përbashkët të studimit Master Ekzekutiv në **"Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore"**, të Universitetit **"Polis"**, janë si vijon:

1. Institucioni, të marrë masa për ruajtjen dhe dokumentimin e aktiviteteve të studentëve të këtij programi studimi, të cilat realizohen si në Universitetin "Polis", po ashtu edhe të atyre që realizohen në universitetin partner, në Itali.
2. Institucioni, në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë së këtij programi studimi, të ndjekë një qasje proaktive, duke adresuar pikat për përmirësim, të identifikuara në procesin e vetëvlerësimit nga aktivitete të ndryshme si: trajnimi, hartimi i praktikave më të mira, etj.
3. Institucioni, të përmirësojë infrastrukturën laboratorike, në funksion të këtij programi studimi, duke shtuar numrin e laboratorëve.
4. Institucioni, të rrisë mbështetjen financiare në kuadër të aktiviteteve kërkimore shkencore, të personelit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi.
5. Institucioni, të shtojë përpjekjet për rritjen e ndikimit të këtij programi studimi, përmes marrëdhënieve të vendosura në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me qëllim tërheqjen e studentëve nga ky rajon.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti "Polis"**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

